



SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS
SINDIKAT KOSOVSKE POLICIJE
KOSOVO POLICE UNION

REFERENCË:	SPK-01/022/22	DATE:05.10.2022
PËR/ZA/TO:	znj. Shehrie LECI , Zyrtare përgjegjëse e Projektligjit për Zyrtaret Publik	
CC:		
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtëpërdrejt	
NGA/OD/FROM:	z. Imer Zeqiri Kryetar i Sindikatës së Policisë së Kosovës	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Komentet nga Sindikata, për projektligjin për zyrtarët publik	



E nderuara znj. Shehrie LECI, Zyrtare përgjegjëse e Projektligjit për Zyrtaret Publik,

Sindikata e Policisë së Kosovës ka analizuar dhe shqyrtuar këtë projektligj e posaçërisht ato nene të cilat kanë pasur vështirësi gjatë zbatimit të Ligjit aktual nr. 06/L-114 për zyrtarët publik.

Në bashkëpunim me ekspertët dhe menaxhmentin e Policisë së Kosovës kemi ardhur në konstatim se këto propozime dhe plotësim ndryshime që po ju dërgojmë janë të domosdoshme për funksionimin e mirëfilltë në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi që janë të ngarkuar me ligjet aktuale dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Policia si institucion i sigurisë është e themeluar dhe funksionon në bazë të dispozitave të përcaktuara në nenit 128 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si pjesë e Kapitullin XI Sektori i Sigurisë, ku gjithashtu janë edhe institucionet tjera Kushtetuese të Sigurisë. Në bazë të dispozitave kushtetuese Policia e Kosovës, ka përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike si dhe përgjegjësinë për kontrollin dhe menaxhimin e kufirit shtetërorë. Këto detyra të përcaktuara me kushtetutë janë zbërthyer më detajisht me Ligjin Nr. 04/L-076 për Policinë si detyra të: mbrojtjes së jetës, pronës dhe ofrimin e sigurisë për të gjithë personat; mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të të gjithë personave; parandalimin e rrezikut ndaj qytetarëve; parandalimit dhe zbulimit veprat penale dhe kryesit e tyre; hetimit të veprave penale dhe kryesve të tyre; mbikëqyrjes dhe kontrollimin e sigurisë në komunikacion; ofrimin të ndihmës gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente si dhe kryerjen e detyrave të tjera të parapara me ligjin në fuqi.

Pasur parasysh specifikat e Policisë si institucione i zbatimit të ligjit është e domosdoshme që trajtimi i personelit policor të bëhet në harmoni me specifikat e parapara kushtetuese dhe me ligjet e aplikueshme. Në këtë kontekst ne konsiderojmë të domosdoshme që punonjësit e Policisë së Kosovës për shkak të specifikave të punës të përjashtohet nga fusha e zbatimit të Ligjit për zyrtarët publik siç janë përjashtuar shumë institucione tjera ne veçanti:

- a) personelin komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo të organizatës tjetër pasardhës;
- b) punësuarit në Agjencinë Kosovare për Inteligjencë;
- c) gjyqtarët dhe prokurorët;

Detyrat dhe përgjegjësitë, autorizimet e Zyrtarëve Policor janë të ngjashme me disa nga institucionet e lartcekura dhe të cilat janë të përjashtuara nga Projektligj. Shembull i mirë për këtë krahasim është se Policia ka strukturë komanduese, hierarkike, uniformë, pajisjet dhe mjetet e veçanta të punës (shembull armët, mjete e blinduara, agjentet kimik, pajisjet për prangim etj), disiplinën, zinxhirin komandues etj. të cilat janë të ngjashme me Forcën e Sigurisë.

Gjithashtu në kuadër të Policisë ka struktura të mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të informacionit si dhe inteligjencës në përgjithësi, kemi zyrtarë të inteligjencës, informatorë dhe struktura tjera të kësaj natyre. Kjo detyrë është e ngjashme me detyrat të cilat i kryejnë edhe zyrtarët e AKI-së.

Pasur parasysh se një nga detyrat kryesore të policisë është parandalimi dhe hetimi i krimit kjo përbënë autorizimin të cilin e kanë zyrtarët policor dhe të cilët kryejnë detyra hetimi, mbledhje, përpunim dhe dokumentim të provave në prokurës parapenale dhe penale, detyrë e cila kryhet bashke me Prokurorinë dhe Gjykatat. Në bazë të autorizimeve të Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, zyrtari i policisë është i autorizuar për të zhvilluar hetime penale ose për të ekzekutuar vendimin e prokurorit të shtetit apo të gjykatës. Për të kryer detyrat e parapara me nenin 70 të Kodit , policia është e autorizuar që: të mbledhë informata nga personat; të kryejë kontroll të përkohshëm të automjeteve, udhëtarëve dhe valixheve të tyre; të kufizojë lëvizjen në zona të caktuara për kohën kur ky veprim është urgjentisht i nevojshëm; të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të vërtetuar identitetin e personave dhe të sendeve; të organizojë kontrollimin për të zbuluar vendndodhjen e individit ose të sendit që kërkohet duke dërguar letërreshtimin; të kontrollojë nën praninë e personit përgjegjës objektet e caktuara dhe lokalet e organeve publike dhe të shqyrtojë dokumentet e caktuara që u përkasin atyre; të konfiskoje kontrabandën apo sendet të cilat mund të shërbejnë si prova në procedurë penale; të sigurojë ekzaminimin fizik të të dëmtuarit, në pajtim me nenin 144 të Kodit; të zbulojë, mbledhë dhe ruajë gjurmët dhe provat nga vendi i ngjarjes për veprën penale të dyshuar dhe të urdhërojë testimin mjekoligjor të atyre provave nga laboratorit i mjekësisë ligjore në pajtim me nenin 71 të Kodit; të merr në pyetje dëshmitarët apo të dyshuarit e mundshëm në pajtim me nenin 73 të Kodit; të ndërmerr hapat e nevojshëm për të parandaluar një rrezik të menjëhershëm për publikun; të ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të gjetur kryerësin dhe për të parandaluar kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja si dhe të ndërmerr hapa dhe veprime tjera të nevojshme siç përcaktohet me ligj. Këto detyra e bëjnë Personelin Policore të ngjashëm për nga funksioni me institucionet e ndjekjes dhe drejtësisë prandaj edhe përjashtimi nga Ligji është më i drejtë.

Përpos specifikave të cilat kanë të bëjnë me natyrën e punës së Policisë e cili i dallon nga zyrtarët e tjerë publik në Ministri dhe Agjencione tjera, përjashtimi i personelit policor nga ky ligj është i nevojshëm për të evituar edhe vështirësitë aktuale të cilat janë në:

1. **Zhvillimi i procedurave të rekrutimit dhe seleksionimit;**
2. **Vlerësimi i Performancës - mos përshtatja e sistemeve të teknologjisë së IT-së, mos bashkëveprimi (interoperabiliteti) i bazave të të dhënave PRIMs i PK-së me SIMBNJ të MAP-it, Policia e Kosovës e ka domain-in e vet "kosovopoliice.com", e cila është ndarë nga domain-i qeveritar "rks-gov.net".**
3. **Policia e Kosovës ka strukturë të përzier të stafit- do me thënë struktura " të integruar" të personelit e ngjashme me Ministrinë e Mbrojtjes, ku përfshihen stafi civil, stafi shëndetësor dhe pjesa e uniformuar;**
4. **Struktura organizative-** Policia e Republikës së Kosovës në bazë të nenit 128 të Kushtetutës ka zinxhir të unifikuar komandues në tërë Republikën e Kosovës, me stacione policore të cilat korrespondojnë me kufijtë komunalë si është përcaktuar me dispozita kushtetuese se organizimi i brendshëm i Policisë së Kosovës, rregullohet me ligj në këtë rast me Ligjin Nr. 04/L-076 Për Policinë Kreu III. Kjo gjithashtu reflekton tek kategoritë e nëpunësve në kuadër të Policisë së Kosovës të cilat janë të sistemuar nga niveli më i lartë i Drejtorisë së Përgjithshme të PK-së që është niveli qendror deri në nivelin më ultë të strukturës organizative niveli lokal që përfshinë atë rajonal dhe stacioneve dhe nënstacioneve policore.
5. **Disiplina- ku ndryshojnë mekanizmat disiplinor, masat dhe shkeljet disiplinore dhe smund të jenë të ngjashme.;**
6. **Aspekti krahasimor-** Në bazë të analizave krahasimore të rregullimeve të shteteve të BE-së dhe ato të rajonit ne kemi vërejte se për Policinë duhet të kemi një rregullim të ndryshëm me Ligjin për Policinë për shkak të specifikave të caktuara është e nevojshme të ketë përjashtim. Një rregullim të tillë çfarë është propozuar në këtë draft ligj nuk kemi mundur ta hasim gjetiu.
7. **Kolizioni në legjislacion-** Është obligim edhe kushtetues për Policinë që disa çështje të rregullohen me Ligj të veçantë në këtë rast Ligjin për Policinë. Për këtë arsye ky draft ligj siç është hartuar bie ndesh me ligjin e Policisë dhe veçanërisht me pjesën e organizimit lidhur me këtë kemi edhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese e cila zbërthen parimin e sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit. Më konkretisht në nenin 87 i Projekt-Ligjit për Zyrtarët Publikë sikurse edhe neni 85 i ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik që është kontestuar para Gjykatës Kushtetuese, ka përcaktuar si në vijim: "Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 (respektivisht Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik) i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj". Duke paracaktuar shfuqizimin e çdo dispozite tjetër në kundërshtim me këtë ligj, kjo nënkupton se do të shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht edhe Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë. Për pasojë, ky veprim juridik do të manifestohet me shkelje prap të parimit kushtetues për sigurinë juridike dhe sundimin e ligjit sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese.

Mbështetur në argumentet e dhëna më lartë Sindikata e Policisë së Kosovës:

PROPOZON

TË NDRYSHOHET neni 3 paragrafi 2 i projektligjit. Në kuadër të këtyre plotësim/ndryshimeve të shtohet një nënparagraf i ri i Projektligjit për Zyrarët Publik të këtë përmbajtjen citojmë **“2.4 të punësuarit në Policinë e Republikës së Kosovës”**

Përmbajtja e Paragrafit 2 të nenit 3 të Projektligjit do të jetë si në vijim:

“ 2. Ky ligj gjithashtu nuk zbatohet edhe për kategoritë në vijim:

- 2.1 gjyqtarët dhe prokurorët;
- 2.2 personelin komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo të organizatës tjetër pasardhëse;
- 2.3 të punësuarit në Agjencinë Kosovare për Inteligjencë;
- 2.4 të punësuarit në Policinë e Republikës së Kosovës;**
- 2.5 drejtorin apo anëtarët e organit drejtues kolegjal të agjencive rregullatore;
- 2.6 personelin e ndërmarrjeve publike, në pronësi të Qeverisë apo të një komune. “

SHTOJCË ME STUDIMET KRAHASIMORE TË ANALIZUARA NË RAPORT ME POLICINË:

I. ASPEKTET KRAHASIMORE E VENDEVE TJERA:

Nga analiza e përgjithshme e bërë draft ligjit dhe legjislacionit të vendeve tjera të cilat janë marrë për bazë për draftim të këtij ligji vërehet se nuk është trajtuar në mënyrë të plotë legjislacioni i cili përfshinë rregullimet për Policinë.

Në bazë të këtyre analizave dhe shembujve të vendeve tjera siç janë Shqipëria, Estonia; Lituania, Letonia; Mali i Zi etj. vërehet se janë analizuar dispozitat në mënyrë parciale të shkëputura nga nenet e caktuara. Kjo formë për fushën e Policisë paraqet një pasqyrim jo të drejtë të fushës që ka qëllim të rregulloj ky draft ligj. Për më shumë kur merret për bazë krahasimore legjislacioni i vendeve të caktuara duhet të merret analizohet në tërësi fusha të cilën e rregullon dhe patjetër duhet të analizohet edhe në raport me legjislacionin që rregullon fushën e Policisë sepse në shumicën e Ligjeve të Shërbimit Civil të këtyre vendeve ka referenca në Ligj të veçante.

1) SHQIPËRIA:

Vërehet se draft ligji ka një ngjashmëri të madhe me Ligjin Nr. 152/2013 për Nëpunës Civil të Shqipërisë. (Ndryshuar me ligjin nr., 178/2014, datë 18.12.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 211). Më konkretisht janë marrë dispozitat e nenit 2 dhe 3 të këtij ligji por jo në tërësi siç është ky nen dhe këtu mendojmë se është bërë gabimi në raport me Policinë. .

Sipas këtij ligji Neni 2 Fusha e veprimtimit përcakton: “ (Shtuar shkronjat “h”, “i”, “j”, “k” dhe “l” me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014) Ky ligj zbatohet për çdo nëpunës (në vazhdim “nëpunës civil”), që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, me përjashtim të: a) të zgjedhurve; b) ministri përgjegjës për administratën publike dhe zëvendësministrit; c) funksionarët e emëruar nga Kuvendi, Presidenti i Republikës ose Këshilli i Ministrave; ç) gjyqtarit dhe prokurorit; d) nëpunësit të administratës gjyqësore; dh) ushtarakut të Forcave të Armatosura; e) personelit të Shërbimit Informativ Shtetëror; ë) personelit të njërive publike direkte të shërbimit; f) anëtarit dhe kryetarit të organeve kolegjiale drejtuese të komiteteve apo institucioneve në varësi të Kryeministrit apo një ministri përgjegjës për administratën publike; g) punonjësit administrativ; gj) funksionarit të kabinetit. h) punonjësve që realizojnë atributet e agjentit/oficerit të Policisë Gjyqësore dhe ata që sipas ligjit lejohet të mbajnë armë; i) civilët në strukturat e Forcave të Armatosura; j) punonjësit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare; k) punonjësit e bordeve të kullimit; l) avokatët pranë Avokatit të Shtetit.

Në bazë të këtij Ligji përcakton kategoritë të cilat rregullon ky ligj. Në nenin 3 të këtij ligji parashihen rastet e veçanta shih më poshtë nenin 3 të këtij Ligji.

Neni 3 Rastet e veçanta

Paragrafi 1. Punonjësi i policisë dhe punonjësi i shërbimit të jashtëm është nëpunës civil, ndaj të cilëve zbatohet ky ligj, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm.

Paragrafi 2. Mund të rregullohen me ligj të posaçëm elemente të marrëdhënieve të shërbimit civil në shërbimin e jashtëm.

Paragrafi 3. Ligji i posaçëm, sipas pikës 2 të këtij neni, mund të rregullojë: a) kushte shtesë për rekrutimin; b) të drejta ose detyrime specifike të tjera nga ato të parashikuara nga ky ligj; c) pozicione të posaçme; ç) rregulla të posaçme për zhvillimin e karrierës, sipas sistemit të gradave.

Në Draft Ligjin për Zyrtarë Publik është marrë vetëm paragrafi 3 i nenit 2 të ligjit të Shqipërisë. Nga leximi dhe analiza e këtij neni është e qartë se Ligji i veçante mund të rregullojë fushat e caktuara të cilat i referohen paragrafit 2 i cili rregullon fushën e Shërbimit të jashtëm por jo edhe të Policisë.

Nëse duhet të merret shembulli i Shqipërisë në këtë nen atëherë ne jemi dakord të merret në tërësi neni 3 rastet e veçanta dhe kjo eliminon problematikën në draft ligjin aktual për fushën e Policisë.

Për më shumë nëse shikohet legjislacioni i Policisë në Shqipëri më konkretisht me Ligjin Nr. 108/2014 për Policinë e Shqipërisë ka shumë dispozita që rregullojnë fushën e marrëdhënieve të punës dhe organizimit të policisë me saktësisht nga neni 7 deri tek neni 96. Në Nenin 39 të Ligjit për Policinë e Shqipërisë përcaktohet “ *Punonjësi i policisë është nëpunës civil, ndaj të cilit zbatohen dispozitat e ligjit për nëpunësin civil, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm*”. Në ligjin për Policinë e Shqipërisë janë përdorur referenca sa here bëhet fjalë për zbatim të Ligjit për nëpunësit civil Shembull: Transferimi neni 44; transferi i përkohshëm neni 45; ndërprerja e marrëdhënieve të punës neni 47. Përpos Ligjit në Shqipëri kanë edhe Rregulloren e Policisë së Shqipërisë (e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave- Qeveria) e cila përcakton në nenin 3 Subjektet i kësaj rregulloreje janë punonjësit e Policisë së Shtetit dhe punonjësit administrativë. Më konkretisht në këtë rregullore në Nenin 3 është përcaktuar “ *Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme edhe për nëpunësit civilë, për aq sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil*”

2) LITHUANIA:

Në Ligjin për Shërbim Civil të Litanisë gjithashtu kemi përjashtime për disa institucione përfshirë edhe Policinë. Më konkretisht në nenin 5 paragrafi 6 janë paraparë rastet ku nuk aplikohen dispozitat e Ligjit të Shërbimit Civil. Në pikën 9 dhe 11 të nenit 5 paragrafi 6 më konkretisht janë përjashtimet për zyrtaret që punojnë në hetime dhe sigurim.

3) ESTONIA:

Në ligji për Shërbim Civil të Estonisë neni 2 paragrafi 2 është përcaktuar: “ *Ky ligj zbatohet për policinë, zyrtarët e burgjeve dhe kërkim shpëtimit, shërbimit të jashtëm dhe prokurorisë... me specifikat të parashikuara me ligje të veçanta* ”

Në Ligjin e Policisë së Estonisë neni 1 paragrafi 6 përcaktohet “ *Ligji i shërbimit Civil zbatohet në fushën e policisë përjashtimisht specifikimeve që rrjedhin nga ky ligj*”

Më konkretisht në Ligjin për Policinë e Estonisë parashihen dispozita për fushën e marrëdhënies së punës nga neni 33 deri 119.

4) SLLOVENIA:

Në Ligjin e Policisë së Sllovenisë në nenin 1 është përcaktuar se” *ky ligj rregullon Organizimin, funksionimin e policisë dhe përcakton veçoritë specifike të marrëdhënieve të punës së punonjësve të Policisë dhe të drejtat e tyre dhe detyrimet*” Me Ligjin Nr. 15/13 për Policinë janë rregulluar në mënyrë më detaje çështjet e organizimit dhe marrëdhënies së Punës.

5) LETONIA:

Në Ligjin për shërbimin Civil të Letonisë neni 2 paragrafi 3 është përcaktuar: “*Kapitulli I; Neni 4, paragrafi dy, klauzola 1; Kapitulli IV; Seksioni 22; Seksioni 23; Seksioni 37; Neni 38, paragrafi tre; Neni 39 dhe neni 40 i këtij ligji zbatohen për nëpunësit civilë të shërbimit civil të specializuar shtetëror (neni 3, paragrafi dy). Me norma të tjera të këtij ligji përcaktohen marrëdhëniet juridike në shërbimin civil të specializuar shtetëror, përderisa këto nuk e përcaktojnë me ligje të veçanta*” . Më tutje në paragrafin 5 të këtij ligji përcaktohet se shërbimet civile të specializuara janë edhe ato në MPB -Policia.

Në Ligjin e Letonisë nuk janë përcaktuar dispozita të qarta në Ligjin për Shërbim Civil në raport me policinë. Në rastin e veçante në këtë ligj përcaktohet në dispozitat përfundimtare “ *nëse dikush dëshiron të punojë në Shërbim Civil nga Policia atëherë vlejnë rregullat e Ligjit Civil*”. Me Ligj për Policinë e Estonisë janë paraparë shumë rregullua të marrëdhënies së punës.

6) KROACIA:

Në Ligjin e Policisë së Kroacisë neni 79 është përcaktuar: “ *rregulloret për nëpunësin civil zbatohen për statusin, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e zyrtarëve policorë që punojnë në Ministri, nëse me këtë ligj dhe rregullore tjera nuk është përcaktuar ndryshe*” Me ligj të Policisë në Kroaci rregullohet marrëdhënia e punës prej nenit 79 deri 124.

7) MAQEDONIA E VERIUT:

Në ligjin e Shërbimit Civil të Maqedonisë neni (5) theksohet se dispozitat e këtij ligji nuk do të zbatohen për “ *... personat me uniformë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, personelin ushtarak dhe civil që shërben në Armatën e Republikës së Maqedonisë, në institucionet penalo-korrektuese dhe edukative-korrektuese dhe në Drejtorinë doganore, si dhe për personat me detyra dhe autorizime të*

veçanta. të punësuar në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Agjencinë e Inteligjencës dhe Drejtorinë doganore, përveç nëse me ligj tjetër parashikohet ndryshe”

Kjo ka mundësuar të rregullohen disa aspekte specifike ndryshe me ligj të Policisë. Më konkretisht në nenin 49 të Ligjit për Policinë e Maqedonisë është përcaktuar ” **Punonjësi i policisë ushtron të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës në përputhje me rregulloret për punësim, marrëveshjen kolektive të Ministrisë dhe këtë ligj**” Pra shihet se marrëdhënia e punës për shkak të specifikave të Policisë është paraparë të rregullohet me Ligj të Policisë. Marrëdhënia e punës në këtë Ligj rregullohet nga neni 94 deri në nenin 119.

8) MALI I ZI:

Në mal të Zi është një rregullim ndryshe. Aty nuk ka dispozitë e veçante e cila bënë përjashtim apo rregullim ndryshe për Policinë dhe institucionet tjera por në kuadër të neneve të caktuara bëhen përjashtime. Në kuadër të Ligjit për Shërbim Civil në Mal të Zi janë paraparë në shumë nene përjashtime të zbatimit të këtij Ligji shembull neni 30 Pozitat; neni 40 Plotësimi i pozitave; Neni 64 caktimi i përkohshëm; neni 81 shpërblimet mirënjohjet.

Përmbajta e përjashtimeve në nenet e caktuara është përafërsisht e njëjtë si në vazhdim“ *Pavarësisht nga rregullat e këtij neni për organet që veprojnë në fushën si diplomacia, policia, siguria, mbrojtja, ruajtja e personave të ndaluar dhe të dënuar dhe kryerja aktivitetet të tjera në ekzekutimin e sanksioneve të paraburgimit ose burgimit dhe masave të sigurisë mund të jenë plotësohet me procedurë alternative, në përputhje me ligj të veçante”.*

Në pajtim me këtë rregullim pastaj me Ligjin për Policinë në Mal të Zi marrëdhënia e punës është e rregulluar nga neni 85 deri neni 109B

Me respekt:
Imer Zeqiri
Kryetar i Sindikatës së Policisë

